

URDHËR
Nr.512, datë 14.10.2011

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE” NË FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në:

a) “Shërbime sociale në drejtësinë penale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në “Shërbime sociale në drejtësinë penale”.

b) “Administrim i çështjeve sociale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në “Administrim i çështjeve sociale”.

c) “Studime rajonale politike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në “Studime rajonale politike”.

d) “Çështje të fëmijëve dhe të familjes”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në “Çështje të fëmijëve dhe të familjes”.

e) “Komunikim për ndryshim social dhe të sjelljes”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në “Komunikim për ndryshim social dhe të sjelljes”.

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike.

3. Programet e studimit të fillojnë në vitin akademik 2011-2012.

4. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe Universiteti i Tiranës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj